



ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRAÇANICA



Në bazë të nenit 51 paragrafi 1 dhe nenit 53 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 („Gazeta zyrtare e RK-së”, nr.28/2008), nenit 27 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e dytë të rregullt, e mbajtur më datën 11.03.2026, merr këtë:

V E N D I M Nr.10/2026/KG

për formimin e Komitetit për Komunitete

Neni 1

Formohet Komiteti për Komunitete në këtë përbërje:

1. Turkijan Tairi, përfaqësues i komunitetit rom,
2. Enes Sopjani, përfaqësues i komunitetit shqiptar,
3. Mersiha Bajrami, përfaqësuese e komunitetit goran,
4. Aziz Karadollami, përfaqësues i komunitetit boshnjak,
5. Florim Bajrami, përfaqësues i komunitetit ashkali,
6. Bojana Mitiq (*Bojana Mitić*), këshilltare e KK të Graçanicës,
7. Bobana Jovanović Trajković (*Bobana Jovanović Trajković*), këshilltare e KK të Graçanicës,
8. Lumnije Gashi, këshilltare e KK të Graçanicës,
9. Nikolla Rashić (*Nikola Rašić*), asamblist i KK të Graçanicës,
10. Milla Zhivković (*Mila Živković*), këshilltare e KK të Graçanicës,
11. Milosh Dimić (*Miloš Dimić*), këshilltar i KK të Graçanicës.

Neni 2

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi anulohet Vendimi nr.61/2025/KG (Numër arkivor 5866/25 i datës 30.12.2025) për formimin e Komitetit për Komunitete.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dorëzimit tek autoriteti mbikëqyrës në kuptimin e nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Arsyetim

Në mbledhjen e dytë të jashtëzakonshme, të mbajtur më datën 30.12.2025, Kuvendi i Komunës së Graçanicës ka marrë Vendim nr.61/2025/KG (Numër arkivor 5866/25 i datës 30.12.2025) për formimin e Komitetit për Komunitete dhe të njëjtin më datën 30.12.2025 ia ka dërguar Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në shqyrtim të ligjshmërisë. Pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit, MAPL-ja ka dërguar një kërkesë (nr.020-650/7 e datës 26.01.2026) për rishikimin e aktit, duke vlerësuar se akti komunal nuk është në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe se ai duhet të rishqyrtohet dhe të harmonizohet me legjislacionin në fuqi, siç përcaktohet në nenin 53 paragrafi 53.1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale: *Komiteti për komunitete përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e kuvendit të komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga, së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të komitetit të komuniteteve.*

Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević
Milan Dimitrijević

